

VENDIM
Nr. 995, datë 9.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 280, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS TËRBUF TË QARKUT TË FIERIT"

(ndryshuar me VKM nr. 1017, datë 16.12.2020)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 280, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në titull dhe në pikën 1, fjalët: "... të komunës Tërbuf ..." zëvendësohen me: "... të Njësisë Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë ...".

b) Në listën e inventarit të ndryshohet sipërfaqja e pronës me numër rendor 796, me numër pasurie 479, në zërin kadastral "Kënetë", me vendndodhje në zonën kadastrale 3547, nga "207 900 m²" në "77 000 m²", sipas formularit dhe planvendosjes, gjithsej 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Shfuqizuar.

3. Ngarkohen Bashkia Divjakë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

3. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Bashkia / Komuna		Ministria / Agjencia		Regjistrimi		Prona		Detaje		Shënime	
Bashkia Divjakë		Ministria e Punëve Publike dhe Transportit		Regjistri i Pronave		Prona e Kënetës		Prona e Kënetës		Shënime	
Emri i Pronës		Adresa		Lloji i Pronës		Vendi i Pronës		Vendi i Pronës		Shënime	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Nr. Pronës	Zona Kadastrale	Emri i Pronës	Adresa	Emri i Pronës	Adresa	Emri i Pronës	Adresa	Emri i Pronës	Adresa	Emri i Pronës	Adresa
796	K-24-100-325-A	479	479	479	479	479	479	479	479	479	479
796	K-24-100-325-A	479	479	479	479	479	479	479	479	479	479

[illegible]